

Oktaj HASANI & Albin HALIMI

**ROLI DHE KONTRIBUTI I GRAVE NË REALIZIMIN E
PROTESTËS STUDENTORE TË 1 TETORIT 1997 NË
KOSOVË**

Protesta studentore e 1 tetorit të vitit 1997 në Kosovë e realizuar nga organizata Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës, përbënë njëren nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të Kosovës. Kjo protestë e cila rikthen vëmendjen e diplomatëve të huaj, ka dhënë impakt goxha të madh në dinamizmin e “Çështjes së Kosovës” në arenën ndërkombëtare. Protesta studentore e 1 tetorit 1997, shpërfaq përpara mediave vendore e ndërkombëtare, dhunën që policia serbe e ushtron mbi studentët që po demonstرونin për liritë dhe të drejtat e tyre themelore, arsimimin dhe edukimin në gjuhën e tyre amtare, gjuhën shqipe.

Organizimi i protestës brenda një periudhe 7-mujore, mars-tetor, shpërfaq edhe rolin e kontributin e grave në menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme që ndodhin në kuadër të kësaj periudhe. Studentet i shohim përveç në organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve përgatitore, në rreshtat e para të studentëve protestues më 1 tetor 1997, në dhënien e intervistave për mediat e huaja, në organizimin e tryezave të diskutimit, në përkthimin e fjalimeve në gjuhë të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë gjuhën gjermane e frënge, andaj edhe ky studim synon të shpërfaq në radhë të parë kontributin e tyre në realizimin dhe mbarëvajtjen e kësaj proteste.

Gratë në realizimin e protestave studentore të vitit 1997

Viti 1997 në Kosovë konsiderohet si vit në të cilin pati një fluks tejet të madh të ngjarjeve kryesisht politike dhe sociale, madje ky vit rezultonte të ishte viti i përhapjes së dhunës nga Beogradi zyrtar, ndaj popullsisë shqiptare, me theks të veçantë ndaj studentëve.¹ Universiteti i Prishtinës (UP)* i hapur në vitin 1970 me mision të qartë, në dekadën e fundit të shekullit XX Beogradi zyrtar, studentëve shqiptarë u mohonte liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për edukim dhe arsimim.² Përkeqësimi i situatës politike në Kosovë në dekadën e fundit të shekullit XX, në të cilat u përfshi edhe suprimimi i Autonomisë së Kosovës më 1989³, autonomi kjo e fituar në vitin 1974⁴ me ndryshimet kushtetuese që ndodhën në Federatën e Jugosllavisë, ndikoi që ndryshime të kishte edhe brenda UP-së.

Studentët dhe profesorët shqiptarë të këtij universiteti në fillim të viteve të '90-ta të shekullit XX do të largoheshin me dhunë nga ambientet e Universitetit⁵, gjë e cila më pastaj do të jetë njëra nga arsyt kryesore për realizimin e protestave studentore në vitin 1997 në Kosovë. Protestat studentore të vitit 1997 u organizuan me të vetmin qëllim, rikthimin e studentëve shqiptarë në ambientet e tyre shkollore dhe arsimimin në gjuhën shqipe. Kjo u bë e qartë edhe në platformën të cilën organizatorët Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës, që ishte organizata e vetme studentore që vepronte në UP dhe mbronte interesat e studentëve, e shpallën më 15 shtator të vitit 1997⁶. Kryetar i kësaj organizate studentore në zgjedhjet e mbajtura më 4 shkurt 1997 ishte zgjedhur Bujar Dugolli⁷. Ndërsa në kryesinë e

¹ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, (Tiranë: Onufri, 2013), 126.

* Nga tani Universiteti i Prishtinës do të shënohet me shkurtesën UP.

² Hajrullah Koliqi, *Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1994*, (Prishtinë: Verana, 1995), 85.

³ Enver Bytyqi, *E drejta për vetëvendosje: rasti i Kosovës*, (Tiranë: 2007), 130; Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, (Prishtinë: KOHA, 2011), 429.

⁴ Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, (Tiranë: Toena, 2008), 352; Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare*, (Tiranë: Toena, 1998), 235.

⁵ Grup autorësh, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, (Tiranë: Botimet Albanologjike, 2023), 723.

⁶ Bujar Dugolli, *1 Tetori i kthesës: Lëvizja Studentore 1997-1999*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2013), 389.

⁷ Muhamet Mavraj, "Bujar Dugolli, kryetar i KE të UPSUP", Bota e Re, Prishtinë, 1997, Nr. 23/24, 3.

ngushtë të organizatës bënë pjesë edhe të tjerë studentë, si: Driton Lajci - nënkryetar, Muhamet Mavraj që ishte kryetar i Kuvendit të Organizatës, Mihane Salihu, Albin Kurti, Athe Hykolli, Ardian Kastrati - anëtarë.⁸

Organizimi i protestave të vitit 1997 sigurisht që kishte një rëndësi të madhe, gjersa edhe sakrificat për funksionimin e tyre ishte po ashtu mjaft e madhe. Për realizimin e protestave u punua me muaj të tërë, ku kontribut për këtë dhanë: studentë, pjesëtarë të shoqërisë civile e veçanërisht profesorët e Universitetit të Prishtinës të cilët krahas studentëve u angazhuan në demaskimin e terrorit serb në Kosovë gjatë viteve të '90-ta.⁹ E në këtë pikë mund të themi që një kontribut të veçantë dhanë edhe gratë. Gratë në fakt, në protestat studentore të vitit 1997 i gjejmë kudo, që nga ditët e para të organizimit të protestave e deri te përfundimi i tyre.

Pa dyshim që njëra nga gratë më aktive në kuadër të kësaj proteste ishte edhe studentja Mihane Salihu. Mihanja, një vajzë që vinte nga qyteti i Prishtinës, studente në Fakultetin Filozofik Drejtimi: Pedagogji ishte bërë aktiviste në UPSUP në vitin 1996. Mihanja ishte edhe njëra nga studentet pjesëmarrëse edhe në protestat studentore të vitit 1991-1992 në Kosovë¹⁰. Pas fitores së zgjedhjeve të 4 shkurtit 1997 dhe krijimit të kryesisë së organizatës, Mihane Salihu ishte e vetmja vajzë e cila bëhet pjesë e kryesisë së ngushtë të organizatës UPSUP¹¹. Përveç Mihanës, në kuadër të UPSUP-së kanë vepruar dhe kanë dhënë kontribut edhe një numër mjaft i madh i grave, në të cilat vlen të përmenden: Mimoza Bujupi, Remzie Shahini, Besa Tovërlani, Lirije Mavraj, Vlora Krasniqi, Valdete Idrizi¹² e shumë gra të tjera

⁸ Bujar Dugolli, *I Tetori...*, 41; Oktaj Hasani, "The attitude of International Community to the October 1997 student protests in Kosovo, before and after outbreak". Revista UNISCI. Madrid: 2022, Nr: 58, 28.

⁹ Bujar Dugolli, *Universiteti i Prishtinës dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës*. Jasharajt dhe lufta çlirimtare, (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, 2019), 152.

¹⁰ Aurela Kadriu, Mihane Salihu Bala, Intervistë pjesa e dytë, Oral History Kosova, Prishtinë, 20 Korrik 2018, <https://www.youtube.com/ëatch?v=7hfV7NqYR9Q> 22.04.2023.

¹¹ Unioni i Pavarur i Studentëve nga tani shkruhet me shkurtesën UPSUP; Dugolli, *I Tetori*, 41; Aurela Kadriu, Mihane Salihu Bala, Intervistë pjesa e dytë, Oral History Kosova, Prishtinë, 20 Korrik 2018, <https://www.youtube.com/ëatch?v=7hfV7NqYR9Q> 22.04.2023.

¹² Intervistë me Remzie Shahini, Prishtinë, 25 Janar 2023.

kontributi i të cilave në realizimin e kësaj proteste ishte jashtëzakonisht i madh.

Për çka në të vërtetë u angazhuan gratë gjatë realizimit të kësaj proteste? Roli i tyre në mbajtjen e kësaj proteste ishte mjaft i rëndësishëm, gjersa secila nga to angazhohej në fushën në të cilën mund të jepte kontribut më të madh, e për këtë zakonisht si një lloj kriteri ishte edhe fusha e studimit. Shembull konkret: në krijimin e banerave të shfaqura në protestën studentore të 1 tetorit 1997 në Prishtinë kryesisht janë përkujdesur studentët nga Fakulteti i Arkitekturës, të cilët janë mentoruar nga profesori i tyre, Flamur Doli.¹³ Njëra nga gratë studente që ka kontribuar në këtë fushë ishte Mimoza Bujupi, që po ashtu në atë kohë ishte studente e Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës. Fotografitë tregojnë se në realizimin e atyre parullave kanë punuar një numër i konsiderueshëm i studentëve nga ky fakultet. Në anën tjetër, studentja nga Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Gjermane, Remzije Shahini, kishte tjetër detyrë. Ajo në protestën e realizuar më 29 tetor 1997 në Prishtinë ishte angazhuar ta përkthente fjalimin e kryetarit të UPSUP-së, Bujar Dugollit, nga shqipja në gjuhën gjermane dhe ta lexonte atë përpara pjesëmarrësve të kësaj proteste.¹⁴

Detyrat ishin të ndara. Ishin formuar dhe komisionet e zbatimit të protestës të cilat merreshin me detyra të caktuara të ndara nga ana e Këshillit Organizativ. Mihane Salihu-Bala pohon se detyra e saj në realizimin e kësaj proteste ishte koordinimi me organizatorët e tjerë të protestave studentore në qytetet tjera të Kosovës. “... Kam kryer edhe aktivitete tjera varësisht çfarë ka qenë e nevojshme duke përfshirë këtu: takimet me studentët e qyteteve tjera, koordinimin, aspektet teknike, punët e mia të sektorit etj.”¹⁵ Gratë shpeshherë në mungesë të rrjeteve teknologjike të komunikimit dhe informimit dërgonin lajmet nga qendra e organizatës në degët e tjera; qoftë në Prishtinë, qoftë në qytetet tjera kur pritej të mbahej protesta. “... Ne kemi bërë

¹³ “Profesor Doli me studentët e arkitekturës duke punuar parullat e ‘97-së”, Kult Plus, 1 Tetor 2018, <https://www.kultplus.com/arti-pamor/profesor-doli-me-studentet-e-arkitektures-duke-punuar-parullat-e-97-s-foto/> 29 Janar 2023; DOKUMENTAR, “Protesta e 1 Tetorit- FUNDI I HESHTJES”, autor: Arsim Lani, Prishtinë, 7 gusht 2020, e qasshme në: <https://www.youtube.com/ëatch?v=JcI0jyVcQNM&t=307s>, 29 Janar 2023.

¹⁴ Bujar Dugolli, *1 Tetori...*, 178.

¹⁵ Intervistë me Mihane Salihu Bala, Prishtinë, 03 Shkurt 2023.

shpërndarjen e këtyre afisheve të cilat i kemi shpërndarë gjatë natës, sepse ideja e pushtetit ishte që ne si vajza nuk involvohemi në gjëra të rrezikshme dhe nuk ishim të rrezikuara të lëviznim, sikurse burrat. Kemi ndihmuar edhe në bartjen e informatave në mungesë të teknologjisë informuese etj.”¹⁶

Po ashtu, duhet theksuar fakti se kishte edhe vajza tjera studente të cilat ishin të angazhuara edhe në komisionin mjekësor. Ky komision ishte i obliguar të jepte ndihmën e parë për të gjithë studentët, të cilët do të mund të pësonin ndonjë lëndim eventual në ditën e protestës më 1 tetor 1997. Në këtë komision një kontribut të veçantë kanë dhënë studentet, si: Drita Mekuli, Zylfije Hundozi, së bashku me shumë shoqe e shokë tjerë.

Dhuna policore ndaj studentëve dhe profesorehave në protestën e 1 tetorit

Protesta studentore e 1 tetorit 1997 dhe dhuna e përdorur nga policia serbe në këtë protestë i vuri “damkën” regjimit totalitar të Millosheviqit në Kosovë. Dhuna e ushtruar nga policia serbe mbi studentët protestues ishte treguesi më i mirë se në Kosovë po shkeleshin liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Studentët shqiptarë ndonëse nuk provokuan situatën por qëndruan të qetë dhe stoik përpara kordonit të policisë serbe, u dhunuan fizikisht gjë për të cilën pasoja të mëdha patën shumë prej studentëve pjesëmarrës në këtë protestë. Burimet e kohës japin informacione nga më të ndryshmet për numrin e studentëve pjesëmarrës në këtë protestë. UPSUP-ja kishte mobilizuar 5 000 studentë që të merreshin me organizimin e Demonstratës së 1 tetorit 1997.¹⁷ Ndërkaq organizatorët theksojnë se kanë printuar 27 mijë bexha-karta të identifikimit për të gjithë qendrat protestuese në Kosovë, gjersa 22 mijë janë ndaluar për t’u shpërndarë tek studentët protestues në Prishtinë.¹⁸ Në anën tjetër, gazeta nga Shqipëria “Rilindja demokratike”, thekson se në protestë ishin pjesëmarrës rreth 30 mijë qytetarë nga e gjithë Kosova¹⁹. Në raportin e

¹⁶ Intervistë me Remzie Shahini, Prishtinë, 25 Janar 2023.

¹⁷ Atdhe Hetemi, *Student Movements for the Republic of Kosovo 1968, 1981 and 1997*, (Germany: palgrave macmillan, X), 221.

¹⁸ Bujar Dugolli..., *1 Tetori*, 151.

¹⁹ “Policia e Millosheviqit përgjakë Prishtinën.” *Rilindja Demokratike*. Tiranë, 2 Tetor 1997, Nr. 226, 5.

Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, thuhet se në të gjithë Kosovën kanë protestuar rreth 300 mijë qytetarë.²⁰ Aktualisht nuk ka një shifër të saktë të studentëve protestues në Prishtinë dhe në viset e tjera të Kosovës, por e rëndësishme është fakti që të zbardhen dhe të kuptohen studentët të cilët u keqtrajtuuan fizikisht në këtë protestë, për të cilët dokumentohet edhe në raportin e KMDLNJ.

Mbi bazën e këtij raporti numërohen një numër i madh i grave të moshave të ndryshme dhe me prejardhje nga viset e ndryshme të Kosovës, të cilat ishin dhunuar fizikisht nga policia serbe më 1 tetor 1997 në qytetin e Prishtinës. Raporti nuk jep detaje për gratë e dhunuara në qytetet (qendrat) tjera protestuese në Kosovë, gjë e cila na lë të kuptojmë se objektivi i pjesëtarëve të policisë serbe jashtë Prishtinës kanë qenë burrat. Megjithatë duke iu referuar këtij raporti po e shfaqim më poshtë listën me gratë e dhunuara fizikisht në protestën studentore të 1 tetorit.

Lista me vajza dhe gra të rrahura-dhunuara fizikisht nga policia serbe në protestën studentore në protestën e organizuar nga UPSUP, më 1 tetor 1997.²¹

Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Qyteti	Profesioni
1. Nexhmije Ymeri	1976	Skënderaj	Studente
1. Ajshe Azemi	1968		Mësimdhënëse
2. Shpresa Sejdiu	1976	Prishtinë	Studente
3. Albanë Hoti	1978		Studente
4. Fatlinda Bajqinca		Prishtinë	Studente
5. Vjollca Shala		Prishtinë	Studente
6. Gezime Sfarça		Prishtinë	Studente
7. Besa Grajçevci		Obiliq	Studente

²⁰ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë, raport për Protesta Studentore Kroinikë Dhune, Prishtinë: Tetor 1997, 3.

²¹ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë, raport për Protesta Studentore Kronikë Dhune, Prishtinë: Tetor 1997, 3,4,5,6,7,8,9.

8. Shpresa Maloku		Vushtrri	Studente
9. Feride Lutfiu		Preshevë	Studente
10. Zemrushe Shabia		Viti	Studente
11. Mirlinda Krasniqi	1977	Obiliq	Studente
12. Luljeta Krasniqi ²²	1982	Prishtinë	Nxënëse
13. Fatime Haxholli			Nxënëse
14. Mevlyde Haxholli			Nxënëse
15. Hikmete Limani			Nxënëse
16. Larta Hasani			Nxënëse
17. Ganimete Morina			Nxënëse
18. Blerta Abazi			Nxënëse
19. Merita Sopi			Nxënëse ²³
20. Sofije Durmishi	1958		Infermiere
21. Besa Bibaj			Nxënëse
22. Fitore Jusufi			Nxënëse
23. Genita Hajdari			Nxënëse
24. Nora Bytyçi			Nxënëse
25. Sabrie Zullufi			Nxënëse
26. Minerva Duraku	1979	Prishtinë	Nxënëse
27. Mimoza Bytyçi			Nxënëse

²² Nxënësjja Luljeta Krasniqi mbi bazën e raportit të KMDLNJ-së të cituar më lartë, është alivanosur pas hedhjes së gazit lotsjellës nga policia serbe në rrugën “Emshiri”, IV/15.

²³ Gratë e rreshtuara në listën e lartëshkruar me numër rendor 13-20, kanë qenë nxënëse në Gjimnazin Filologjik “Eqrem Çabej”.

28. Albana Jaha	1982		Nxënëse ²⁴
29. Sebahate Bunjaku	1968		Studente
30. Artana Bardhaj	1976	Prishtinë	Studente
31. Hajrie Qabiqi		Klinë	Studente
32. Afërdita Zeka			Studente
33. Afërdita Krasniqi			Studente
34. Hamide Hoxha			Studente
35. Valbona Bajrami ²⁵			Studente
36. Lirije Beha			Studente
37. Vlora Pavataj	1970	Deçan	Studente
38. Florina Ibrahimimi	1977	Gjilan	Studente
39. Anita Qerimi	1975	Gjilan	Studente
40. Valentina Hoti			Studente
41. Ylfete Rudari	1980	Podujevë	
42. Sebahate Bunjaku	1971	Glllogoc	
43. Arditë Kajtazaj		Istog	Studente
44. Vlora R. Zeqiraj ²⁶		Istog	Studente
45. Zanfina Ademi		Prishtinë	Nxënëse
46. Sevdie Ahmeti ²⁷			

²⁴ Gratë e rreshtuara në listën e lartëshkruar me numër rendor 22-29 kanë qenë nxënëse në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prishtinë, “Dr. Ali Sokoli”.

²⁵ Studente e Fakultetit Filozofik, e cila qëndroi në gjendje kome për disa orë.

²⁶ Për shkak të gazit lotsjellës pësoi alivanosje dhe kërkoi ndihmën e mjekut.

²⁷ Udhëheqëse e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, policia serbe ia konfiskoi aparatën.

47. Sanije Rusinovci	1980	Prishtinë	Nxënëse
48. Merita Sejdiu	1981	Prishtinë	Nxënëse
49. Ajete Dërguti	1953		Mësimdhënëse
50. Florije Avdiu	1965	Prishtinë	Mjeke
51. Laura Qehaja	1979		Studente
52. Arlinda Zymberi	1977		Studente
53. Xhejlane Slllovinja	1981	Prishtinë	Nxënëse
54. Fatime Mehmeti	1949		Punëtore grafike në shtypshkronjë n “Rilindja”
55. Belgjzare Konjuhi	1973	Lipjan	Juriste
56. Arta Shehu	1970		Studente
57. Luljeta Hetetmi	1974	Glllogoc	Studente
58. Remzije Bajrami	1975	Gjilan	Studente
59. Shyhrete Kastrati	1969	Kamenicë	Studente
60. Elvira Mehmetaj	1981		Nxënëse
61. Turkane Dalipi	1978		
62. Ganimete Ejupi	1981		
63. Feride Dalipi	1945		Amvise
64. Flora Çitaku			Studente
65. Sabrije Fazliu			Studente
66. Mirushe Islami	1976	Podujevë	Studente
67. Shpresa Krasniqi			Nxënëse

Bazuar në raportin e hartuar nga ana e KMDLNJ-së në Prishtinë del se policët serbë gjatë ndërhyrjes së tyre kundër studentëve protestues me theks të veçantë grave, nuk kanë shikuar për moshën, mirëpo vetëm i kanë zbatuar urdhëratë e lëshuara për ta.

Faktet dëshmojnë se në protestën e studentëve të Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, më 1 tetor 1997 në Prishtinë, policia serbe ka dhunuar fizikisht edhe një numër të madh të vajzave të mitura të cilat ishin nxënëse në shkollat e mesme të qytetit të Prishtinës. Bazuar në të dhënat të cilat i kemi marrë në këtë raport, konkludojmë se moshja më e re e vajzave shqiptare të dhunuara fizikisht në kuadër të kësaj proteste është 15 vjeç. Konkretisht kemi specifikuar emra si: Luljeta Krasniqi (1982),²⁸ Albana Jaha (1982), Merita Sejdiu (1981), Xhejlane Slllovinja (1981), Elvira Mehmetaj (1981), Ganimete Ejupi (1981), Ylfete Rudari (1980) dhe Sanije Rusinovci (1980). Përveç kësaj në këtë protestë pati edhe gra tjera të dhunuara fizikisht. Sipas raportit të KMDLNJ-së, Feride Dalipi (1945) është gruaja më e vjetër e dhunuar fizikisht në këtë protestë, pastaj Fatime Mehmetin (1949) dhe Ajete Dërguti (1953).

Duke u bazuar në këtë raport konkludojmë se pavarësisht moshës, gjinisë, profesionit, pjesëmarrësit e kësaj proteste i janë nënshtruar një dhune të rreptë të policisë serbe. Pavarësisht se nuk ka pasur e as nuk dëshmohet ndonjë provokim i nxitur nga pala protestuese, policia serbe ka qenë e pamëshirshme për studentët dhe qytetarët protestues më 1 tetor 1997. Një gjë e tillë tregon më së miri regjimin serb që po mbizotëronte në Kosovë në vitet e '90-ta dhe situatën e vërtetë me të cilën po ballafaqohej populli shqiptar i Kosovës.

Andaj duke i analizuar faktet, argumentet dhe të dhënat tjera konkludojmë se:

- gratë dhanë një kontribut kyç në realizimin e protestës studentore të 1 tetorit 1997;
- kontributi i grave u shfaq në disa fusha të caktuara varësisht nga profili i studimeve të tyre, kështu gratë të cilat studionin mjekësinë dhanë kontribut në Komisionin e Shëndetësisë, gratë që studionin arkitekturë dhe art kontribuan në krijimin e banerave, gratë që

²⁸ Nxënësjja Luljeta Krasniqi mbi bazën e raportit të KMDLNJ-së të cituar më lart, është alivanosur pas hedhjes së gazit lotsjellës nga policia serbe në rrugën "Emshiri", IV/15.

studionin letërsi dhe gjuhë të huaja kontribuan në përkthimin e komunikatave të ndryshme të cilat i lëshonte UPSUP;

-falë grave komunikimi mes pjesëtarëve të UPSUP-së ishte më i lehtë. Kjo për faktin se ato, në mungesë të mjeteve teknologjike të informimit dhe komunikimit, i bartnin informatat tek anëtarët e tjerë të organizatës ngaqë lëviznin më lirshëm sesa burrat në qytetin e Prishtinës;

-pavarësisht moshës në protestën studentore të 1 tetorit 1997 shohim një numër të madh të grave pjesëmarrëse në kauzën për respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Si përfundim, asnjë pushtet nuk i ka bërë ballë lëvizjeve studentore edhe në ato pak raste ku këto lëvizje janë shtypur, gjithmonë pasojat kanë qenë shumë të mëdha për forcat në pushtet. Vizioni largpamës, që studentët e 1 tetorit e shfaqën në organizimet e tyre, ishte shumë herë më i fuqishëm se një aparat i vjetër shtetëror, i cili e mbante me dhunë pushtetin e tij në Kosovë.